

**VENDIM**  
**Nr.1, datë 30.1.2004**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

|                   |                                |
|-------------------|--------------------------------|
| Fehmi Abdiu       | Kryetar i Gjykatës Kushtetuese |
| Zija Vuci         | Anëtar i “ “                   |
| Gjergj Sauli      | Anëtar i “ “                   |
| Alfred Karamuço   | Anëtar i “ “                   |
| Kujtim Puto       | Anëtar i “ “                   |
| Xhezair Zaganjori | Anëtar i “ “                   |
| Petrit Plloçi     | Anëtar i “ “                   |
| Sokol Sadushi     | Anëtar i “ “                   |
| Kristofor Peçi    | Anëtar i “ “                   |

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 3.12.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.42 Akti që i përket:

**KËRKUES:** NJË GRUP PREJ 1/5 E DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga deputeti Lekë Çukaj.

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:**

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, në mungesë.

**KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**, përfaqësuar nga zoti Sokol Shazi, me autorizim.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi si i papajtuashëm me Kushtetutën i pikës 3 të nenit 14 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

- Interpretimi i nenit 64/1 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 124 e 131/c të Kushtetutës, si dhe neni 49 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

Kërkuesi ka paraqitur dy kërkesa në të cilat parashtrohet këto shkaqe:

- Neni 64/1 i Kushtetutës përcakton përpjesëtimin e përbërjes së Kuvendit në varësi të mënyrës së përfaqësimit të sovranitetit të popullit sipas mënyrës së zgjedhjes: 100 deputetë drejtpërdrejt nga zonat njëemërore dhe 40 nga listat shumëemërore në bazë të rezultatit proporcional.

- Duke u zbatuar pika 3 e nenit 14 të Kodit Zgjedhor në një rast praktik, ndryshoi përbërja e Kuvendit për mënyrën e përfaqësimit, me 99 deputetë të zgjedhur nga zonat njëemërore dhe 41 nga listat proporcionale, gjë që vjen në kundërshtim me nenin 64/1 të Kushtetutës.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kristofor Peçi, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjektit të interesuar dhe bisedoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

Kërkuesi, në seancë gjyqësore, duke konfirmuar shkaqet e kërkesës, e kufizoi objektin e saj vetëm për fjalinë e parë të pikës 3 të nenit 14 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, që ka këtë përmbajtje: “Kur mandati i një deputeti të zgjedhur në një zonë zgjedhore njëemërore mbaron në mënyrë të parakohshme, vendi i tij plotësohet nga kandidati i radhës i listës shumëemërore të subjektit zgjedhor përkatës”.

Gjykata Kushtetuese, para fillimit të seancës gjyqësore, për shkak të lidhjes së drejtpërdrejtë të dy kërkesave të paraqitura nga grupi i deputetëve bëri, me një vendim të veçantë, bashkimin e tyre në një çështje të vetme. Në këtë mënyrë, kërkesa për interpretim abstrakt të nenit 64/1 të Kushtetutës

merr zgjidhje nëpërmjet shqyrtimit e kontrollit të kushtetutshmërisë së pikës 3 të nenit 14 të Kodit Zgjedhor.

Nga përmbajtja e kërkesës dhe shqyrtimi i çështjes në seancë rezulton se Kuvendi i Shqipërisë, në zbatim të pikës 3 të nenit 14 të Kodit Zgjedhor, pas mbarimit në mënyrë të parakohshme të mandatit të një deputeti për shkak të dorëheqjes, ka filluar procedurat për zëvendësimin e tij. Me shkresën nr.1974, datë 19.9.2003, Kuvendi i Shqipërisë ka vënë në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kandidaturën zëvendësuese nga lista shumemërore e koalicionit “Bashkimi për fitore” dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e ka shpallur atë me vendimin nr.1846, datë 24.9.2003. Deputeti i shpallur ka bërë betimin në seancën plenare të datës 14.10.2003.

Gjykata Kushtetuese e çmon të nevojshme që në shqyrtimin e kushtetutshmërisë së dispozitës ligjore të përcaktuar në objektin e kërkesës të analizojë disa aspekte që lidhen me sistemin zgjedhor, me mënyrën dhe procedurat e zgjedhjes së deputetëve dhe të zëvendësimit të tyre në rastet e mbarimit të parakohshëm të mandatit, si dhe rregullimin juridik të tyre në periudhën postkomuniste si para, ashtu edhe pas miratimit të Kushtetutës.

Sipas ligjit të zgjedhjeve të vitit 1992, Kuvendi përbëhej nga jo më pak se 140 deputetë, nga të cilët 100 zgjidhen drejtpërdrejt në zonat njëmërore, kurse mandatet shtesë kompensuese, sipas një formule të caktuar, u jepeshin kandidatëve në listat e subjekteve sipas proporcioneve të votave të fituara në raundin e parë.

Ligji i zgjedhjeve i vitit 1997 ndryshoi atë të vitit 1992 në përcaktimin e numrit të deputetëve nga jo më pak se 140 në 115 deputetë, ndryshim që çoi në rritjen e numrit të deputetëve që zgjidhen nga listat njëmërore në 115. Ndryshoi edhe përqindja e minimumit të votave për proporcionalin nga 4 % në 2 %.

Ligjet e mëvonshme, të dala pas miratimit të Kushtetutës, në formën e kodeve zgjedhore që janë ai nr.8609, datë 8.5.2000 dhe nr.9087, datë 19.6.2003, i përmbahen sistemit zgjedhor të përcaktuar në nenin 64 të Kushtetutës, pra sistemit të përzier.

Duke e parë problemin e sistemit zgjedhor në mënyrë kronologjike sipas ligjeve zgjedhore të dala për një periudhë mbi 10-vjeçare, rezulton se pavarësisht nuancave të veçanta, përgjithësisht është zbatuar sistemi i përzier, ku elementet maxhoritare janë më të dukshme, kurse elementet e sistemit proporcional kanë synuar të zbusin ndonjë shpërpjesëtim të shkaktuar nga sistemi maxhoritar.

Lidhur me zëvendësimin e një deputeti për shkak të mbarimit të parakohshëm të mandatit, zgjidhjet ligjore, në periudha të ndryshme, kanë veçoritë e tyre. Në nenin 81 të ligjit nr.7556, datë 4.2.1992 parashikohej se në rast të mbarimit para afatit të mandatit të deputetit, Komisioni i Mandateve shpall të zgjedhur kandidatin e radhës në listën në shkallë vendi. Kur deputeti nuk përfaqëson një subjekt që ka lista në shkallë vendi, në zonën e tij kryhen zgjedhje brenda 3 muajve. Kur deputeti merr përsipër një detyrë tjetër që nuk pajtohet me mandatin e tij, zëvendësohet nga kandidati i radhës në listën përkatëse në shkallë vendi.

Kurse Kodi Zgjedhor i vitit 2000, në nenin 11, parashikonte plotësimin e vendit vakant të deputetit në dy mënyra, në varësi të zgjedhjes së tij. Kur deputeti ishte zgjedhur nga lista shumemërore, plotësimi bëhej nga kandidati i radhës në listë, ndërsa për deputetin e zgjedhur në zonën njëmërore, zëvendësimi bëhej nga një deputet i ri i zgjedhur nga zgjedhjet e së njëjtës zone. Sipas pikës 4 të këtij neni, kur mandati i një deputeti të zgjedhur në një zonë njëmërore mbaron në mënyrë të parakohshme gjatë 6 muajve të fundit të mandatit të Kuvendit, plotësimi bëhet nga kandidati i radhës i listës shumemërore të subjektit zgjedhor përkatës.

Në nenin 14 të Kodit të ri Zgjedhor, i cili është edhe objekt i kërkesës, ka një rregullim të ndryshëm përse i përket plotësimit të vendit të deputetit të zgjedhur në një zonë njëmërore. Në këtë rast, vendi i tij plotësohet nga kandidati i radhës i listës shumemërore të subjektit zgjedhor përkatës.

Krahasimi i përmbajtjes së këtyre dy dispozitave ligjore evidenton qartë një dallim thelbësor mes tyre. Në rastin e parë janë përcaktuar zgjidhje të ndryshme të plotësimit të vendit të deputetit në varësi të mënyrës së zgjedhjes, kurse në rastin e dytë, pavarësisht nga mënyra e zgjedhjes, zëvendësimi është i njëjtë: nga listat shumemërore.

Duke bërë të qartë këtë dallim, çështja shtrohet nëse përmbajtja e fjalisë së parë në pikën 3 të nenit 14 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 vjen në kundërshtim me nenin 64 të Kushtetutës, apo formulimi i ri është më i përshtatshëm dhe nuk cenon raportet kushtetuese të përfaqësimit brenda sistemit të përzier zgjedhor.

Sistemi i zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, i përcaktuar në nenin 64 të Kushtetutës, është një sistem i përzier me elemente të maxhoritarit që janë mbizotëruese dhe i plotësuar me elemente proporcionale. Kjo për faktin se nga numri i përgjithshëm prej 140 deputetë, 100 prej tyre zgjidhen drejtpërdrejt në zonat njëemërore dhe 40 nga listat shumemërore të partive ose të koalicioneve të partive. Zgjedhja e mbi 2/3 të deputetëve në zonat njëemërore dhe marrja për bazë e këtyre rezultateve në ndarjen e mandateve plotësuese, përcaktimi i numrit maksimal të deputetëve pa lejuar rritjen e tij dhe mënyra e ndarjes së mandateve plotësuese, sipas paragrafit të dytë të nenit 64 të Kushtetutës, në një raport sa më të afërt me votat e vlefshme të marra në të gjithë vendin, përbëjnë elementet e një sistemi të përzier zgjedhor, në të cilin ndikimin më të madh e kanë elementet maxhoritare. Për të plotësuar kuadrin e këtij sistemi të përzier, në pikën 3 të nenit 64 të Kushtetutës, është parashikuar përjashtimi nga përfitimi prej listave shumemërore i partive dhe i koalicioneve që marrin përkatësisht më pak se 2.5 % dhe 4 % të votave të vlefshme në të gjithë vendin në raundin e parë të zgjedhjeve.

Në përcaktimin e një sistemi zgjedhor duhet të merren në konsideratë shumë faktorë, siç janë ata historikë, politikë, etnikë, kulturorë, shoqërorë ose gjeografikë. Çdo sistem zgjedhor në një shoqëri demokratike synon të sigurojë stabilitet dhe qeverisje efektive e të qëndrueshme dhe njëkohësisht të sigurojë një përfaqësim sa më të gjerë të popullit dhe një shprehje sa më të plotë të vullnetit të tij. Në parim, çdo sistem zgjedhor konsiderohet në tërësinë e tij demokratik, në qoftë se nëpërmjet tij respektohen të gjitha rregullat e një konkurrimi të drejtë e të barabartë.

Në radhë të parë, sistemi zgjedhor dhe procedurat që lidhen me zbatimin e tij duhet të garantojnë e të vënë në zbatim përfaqësimin real të komunitetit dhe ushtrimin adekuat të sovranitetit të popullit.

Neni 2 i Kushtetutës, duke sanksionuar sovranitetin e popullit si një parim të rëndësishëm kushtetues, në pikën 2, përcakton edhe mënyrën e ushtrimit të tij nëpërmjet përfaqësuesve ose drejtpërsëdrejti. Përfaqësimi i popullit në Kuvend bëhet sipas nenit 64 të Kushtetutës me zgjedhjen e drejtpërdrejtë të deputetëve në çdo zonë zgjedhore. Fitues është ai që ka marrë numrin më të madh të votave, të cilat shprehin dëshirën dhe vullnetin e popullit. Kandidatët e listës zgjidhen sipas renditjes që bën subjekti zgjedhor.

Në zbatim të nenit 64 të Kushtetutës, i gjithë vendi është ndarë në 100 zona zgjedhore me numër të përafërt zgjedhësish dhe çdo zonë ka përfaqësuesin e vet si deputet në Kuvend. Zëvendësimi, qoftë edhe i një deputeti të zgjedhur në zonën njëemërore me një tjetër të listës proporcionale, cenon raportin e përcaktuar nga Kushtetuta. Vlerësimi i elementeve që i përkasin aspektit proporcional në një sistem zgjedhor të përzier nuk duhet të prekë në mënyrë thelbësore elementin tjetër bazë të sistemit, prandaj është kusht “sine qua non” që në çdo dispozitë ligjore të bëhen rregullimet e nevojshme, pa prekur kriteret dhe raportet e vendosura nga Kushtetuta. Përmbajtja e fjalisë së parë të pikës 3 të nenit 14 të Kodit Zgjedhor prek pikërisht ato raporte të vendosura në Kushtetutë, prandaj është e papajtueshme me të.

Meqënëse me shfuqizimin e dispozitës objekt kërkesë krijohet boshllëk ligjor, lidhur me mënyrën e zëvendësimit të deputetit të zgjedhur në zonën njëemërore, i takon Kuvendit të Shqipërisë të bëjë plotësimet e nevojshme në Kodin Zgjedhor.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/a e 134/c të Kushtetutës, si dhe të neneve 49, 72 e 76 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

#### VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të fjalisë së parë në pikën 3 të nenit 14 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, me këtë përmbajtje: “Kur mandati i një deputeti të zgjedhur në një zonë zgjedhore njëemërore mbaron në mënyrë të parakohshme, vendi i tij plotësohet nga kandidati i radhës i listës shumemërore të subjektit zgjedhor përkatës.”.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren

Zyrtare.